




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCY AGAINST CORRUPTION	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-2093/2012
Nr. fta. 02	Data 13.06.2012
Bro. stranca	Datum
Nr. pages	Datë



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-5093/11, për Zyrtarin e Lartë, z. Liridon Dalipi, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-5093/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Liridon Dalipi, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media dhe gjatë kësaj kohe ka qenë i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve si pronarë dhe person i autorizuar në Biznesin "INTELPOINT CONSULTING", dhe ne të njëjtën kohë ka ushtruar edhe funksionin e zyrtarit të Lartë si, Drejtor Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 30.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Liridon Dalipi, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media, ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë si dhe ka ardhur te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia, gjate takimit qe është mbajtur ne zyrat e AKK-se është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Liridon Dalipi , gjatë takimit është pajtuar për situatën, mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar për këtë, pasi qe nuk e ka informuar askush qe nga momenti i zgjedhjes si dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë qe mundë te shkaktoj Konflikt te mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, pasi qe ka menduar se biznesi qe ka qen regjistruar por nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet dhe është pasiv, mund te shkaktoj Konflikt te Interesit

z.Liridon Dalipi, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media, është zotuar se ne afatin ligjor do te bej azhurnimin e te dhënave apo do ta shuaj këtë biznes pasi nuk qe nuk zhvillon asnjë aktivitet, dhe do ta bej shmangien konfliktit te mundshëm të interesit gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik si Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media.

Me datën 11.05.2012, Zyrtari i Lartë, z.Liridon Dalipi, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Komisionin e Pavarur për Media, ka sjellë dëshminë se ka bartur aksionet tek dikush tjetër dhe nuk ka asnjë funksion menaxhuese ne atë biznes, më ane te dokumentit te lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, dëshmohet se z.Liridon Dalipi nuk është me pronarë dhe nuk ka funksione menaxhuese andaj konsiderojmë se z.Liridon Dalipi ka shmangur gjendjen e mundshme te Konfliktit te Interesit ne te cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

